



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASENIT UJOR VJOSË

Nr 24 / Prot
6

Vlorë, më 08 . 11 . 2023.

VENDIM

Nr. 11, datë 02.11.2023

PËR

**MOSMIRATIMIN E KËRKESËS PËR LEJE PËR PËRDORIM BURIMI
UJOR SIPËRFAQËSOR PËR PRODHIM HIDROENERGJETIK,
TË SUBJEKTIT “AGE KUÇ” SH.P.K.**

Në mbështetje të shkronjës “b” të pikës 2, të nenit 41, të ligjit nr.111/2012, “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, i ndryshuar dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.550, datë 15.07.2020, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim për dhënien me koncension të përdorimit të burimit ujqor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujqor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujqor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujrave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimarrjes, të formateve të lejes, të autorizimit, të kushteve të posaçme dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujqor Vjosë,

KONSTATOISE:

Nëpërmjet sistemit elektronik e-leje “Aplikim për përdorim burimi ujqor” shoqëria “AGE KUÇ” sh.p.k ka paraqitur kërkesën për leje për përdorim burimi ujqor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjetik”, nëpërmjet HEC KUÇ, me vendndodhje: *Në rrjedhën e sipërme të pellgut ujëmbledhës të Lumit të Shushicës, në afërsi të Fshatit Kuç, Bashkia Himarë, Qarku Vlorë.*



Shoqëria “AGE KUÇ” sh.p.k ka dërguar në sistemin elektronik “Aplikim për përdorim burimi uJOR”, datë 09.02.2023, plotësimet e dokumentacionit, sipas kërkesave të VKM 550/2020. Në vijim, në zbatim të parashikimeve të kësaj VKM-je, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, ka ndjekur procedurën e bashkërendimit. Pas shqyrtimit të dokumentacionit tekniko-ligjor të aplikimit, referuar VKM-së 550/2020, më datë 07.03.2023 përgatiti materialin e nevojshëm për shqyrtim në mbledhjen e rradhës së KBU Vjosë.

Rezultoi se deri në mbledhjen e radhës ku u shqyrtua kërkesa e subjektit, kishte hyrë në fuqi VKM nr.155, datë 13.03.2023 “Për shpalljen e ekosistemit natyror të Lumit Vjosa “Park Kombëtar”, kategoria e II”, konkretisht koha e hyrjes në fuqi më datë 16.03.2023. Në këto kushte, nisur nga fakti që përcaktimet e këtij Vendimi të Këshillit të Ministrave lidhen edhe me zbatimin e detyrave të AMBU-së në procesin e shqyrtimit të kërkesave për leje/autorizim përdorim burimi, në zbatim të VKM 550/2020 përsa i përket procesit të bashkërendimit, AMBU iu drejtua Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM) me kërkesën për interpretimin e këtij vendimi. Konkretisht duke i parashtruar AKZM-së, në cilësinë e institucionit përgjegjës për zbatimin e përcaktimeve të ligjit “Për Zonat e Mbrojtura” dhe të VKM-së 155/2023, udhëzime lidhur me mënyrën se si do të zbatohen kërkesat e këtij vendimi gjatë shqyrtimit të aplikimeve për përdorim burimi uJOR në tërësi dhe konkretisht të aplikimeve aktualisht në proces, me vendndodhje veprimtarie në basenin e lumit Vjosë, në zonën e përcaktuar sipas vendimit 155/2023.

Në përgjigje, AKZM-ja me anë të shkresës nr.1889/1 prot., datë 31.05.2023, protokolluar pranë AMBU-së me nr.734/1 prot., datë 02.06.2023, lidhur me zbatimin e VKM nr. 155/2023 ka bërë me dije se në lidhje me shoqërinë “AGE KUÇ” është shprehur me dhënie mendimi, nëpërmjet sistemit e-leje në Qershor të vitit 2022 se sipërfaqja ku do të zhvillohet aktiviteti “Ndërtimi i Hidrocentralit Kuç, në rrjedhën e sipërme të pellgut ujëmbledhës të lumit të Shushicës, nuk ndodhej brenda rrjetit të zonave të mbrojtura”. Me VKM-në nr.155/2023 “Për shpalljen e ekosistemit natyror të Lumit Vjosa “Park Kombëtar”, kategoria e II” dhe referuar koordinatave të veprës së marrjes, rezulton se ky aktivitet do të zhvillohet brenda territorit të Parkut Kombëtar “Lumi Vjosa”. Sa më sipër, ky aktivitet nuk mund të zhvillohet.

Në vijim të përgjigjes së mësipërme, AMBU, me anë të shkresës nr.734/2 prot., datë 09.06.2023 ka vënë në dijeni subjektin “AGE KUÇ” sh.p.k dhe Kryetarin e Këshillit të Basenit UJOR Vjosë lidhur me qëndrimin e mbajtur nga AKZM-ja në lidhje me



këtë aplikim. Shoqëria “AGE KUÇ” sh.p.k me anë të shkresës nr.128 prot., datë 21.06.2023, protokolluar në Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU) me nr. 734/3 prot., datë 22.06.2023, ka dërguar pretendimet se është plotësisht në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe kërkon miratimin e lejes së përdorimit të burimit ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjetik HEC KUÇ.

Në kushtet e mësipërme, kërkesa e subjektit është përfshirë në rendin e ditës në mbledhjes e radhës. Në këtë mbledhje, KBU Vjosë vendosi që kjo kërkesë të shqyrtohej në mbledhjen e ardhshme pasi referuar qëndrimin të mbajtur nga AKZM dhe pretendimeve të dërguara nga subjekti, pasi u vlerësua e nevojshme sërish mendimi i institucionit përgjegjës për zbatimin e parashikimit të VKM 155/2023 për aplikimin e subjektit.

Rezultoi se, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, në përgjigje të shkresës së dërguar nga KBU Vjosë, përmes së cilës kërkohej interpretim mbi zbatimin e pikës 5, VKM-së nr. 155, datë 13.05.2023 “Për shpalljen e ekosistemit natyror të lumit Vjosa Park Kombëtar, kategoria II”, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura është shprehur se bazuar në VKM 155/2023 dhe referuar koordinatave të veprës së marrjes, duke qenë se rezulton se ky aktivitet do zhvillohet brenda territorit Parku Kombëtar “Lumi Vjosa”, **ky aktivitet nuk mund të zhvillohet**, duke arsyetuar se referuar gjurmës c, të pikës 2, të nenit 16, të ligjit nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura në “Parkun kombëtar” zbatohet shkalla e mbrojtjes mjedisore të zonës ka si objektiv të mbajë territorin në gjendje natyrore, ku të ruhen komunitetet biotike, të resurseve gjenetike dhe llojeve për të siguruar stabilitetin ekologjik dhe diversitetin dhe ku: c) janë të ndaluara ndërtimi i zonave urbane, i autostradave, hekurudhave, linjave të prodhimit energjisë, hidrocentrale, linjave tensionit të lartë dhe sistemeve naftës e gazit me shtrirje të gjatë; Po ashtu, kjo mbështetet edhe parashikimet e pikës 6 të këtij vendimi, ku parashikohet se për veprimtaritë për të cilat nuk është lidhur kontrata përkatëse me autoritetin kontraktues, pavarësisht, zhvillimit të procedurave apo kontratave që në ditën e hyrjes në fuqi të vendimi nuk kanë plotësuar kushte përkatëse të kontratës nuk lejohen të zhvillohen brenda territorit të Parkut Kombëtar të lumit të Vjosës, në rast se vijnë haptazi në kundërshtim me kërkesat e nenit 16, të ligjit nr. 81/2017, “Për zonat e mbrojtura”. Ndodhur në kushtet ku veprimtaria që kërkohet të zhvillohet shtrihet në zonën e Parkut Kombëtar të Lumit Vjosa, ligji nr.81/2017 “Për zonat e mbrojtura” ka parashikuar se cdo të ndodhë edhe me situatën e kontratave të fituara për veprimtaritë që do zhvillohen në Zonat e Mbrojtura. Konkretisht, bazuar në pikën 1, të nenit 73, të ligjit nr.81/2017, pavarësisht se mund të jenë fituar të drejta për të

ushtruar veprimtari të caktuara në zonat e mbrojtura, duke lidhur marrëveshje, kontratë apo janë pajisur me leje mjedisi për to, do të vazhdojnë të kryhen vetëm kur nuk ndalohen shprehimisht nga ky ligj apo nuk vijnë haptas në kundërshtim me të. Si përfundim, mbështetur në ligjin nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, VKM nr. 155/2023 “Për shpalljen e ekosistemit natyror të Lumit Vjosa “Park Kombëtar”, si dhe në dokumentat e referuara në shkresën e KBUV, kjo veprimtari nuk mund të zhvillohet në territorin e parkut kombëtar të lumit Vjosë.

Në mbledhjen e radhës datë 2.11.2023 kërkesa e subjektit ka qënë sërish pjesë e rendit të ditës. Duke patur qëndrimin e mësipërm zyrtar, u arrit në një vendimmarje për kërkesën e subjektit.

PËR KËTO ARSYE:

Këshilli i Basenit Ujor Vjosë, bazuar në gërmën (ç), të pikës 14, të Kreut IV, të VKM-së nr.550, datë 15.07.2020, dhe në vendimin nr.6, datë 12.06.2019, “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Basenit Ujor”, të Këshillit Kombëtar të Ujit,

V E N D O S I:

1. Mosmiratimin e kërkesës për leje për përdorim burimi ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjetik, të subjektit “Age Kuç” sh.p.k.
2. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektit.



K R Y E T A R

FLAMUR MAMAJ